



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në bazë të nenit 94 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/18 dhe 178/21) dhe nenit 85 pika 17 dhe nenit 101 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Senati i Universiteti i Tetovës, në seancën e mbajtur më 12 maj 2023, miraton këtë

VENDIM

për formimin e Komisionit Universitar të Zgjedhjeve për zbatimin e procedurës për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës, për mandatin 2023 - 2026

Neni 1

(1) Merret vendim për formimin e Komisionit Universitar të Zgjedhjeve për zbatimin e procedurës për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës, për periudhën e mandatit 2023 - 2026, me këtë përbërje:

1. Flamure Ibraimi Sadiku – Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
2. Qenan Ferati – Fakulteti i Shkencave Mjekësore
3. Zeqirja Idrizi – Fakulteti Filozofik
4. Besa Dogani – Fakulteti Pedagogjik
5. Milazim Kamberi – Fakulteti i Kulturës Fizike
6. Metin Izeti – Fakulteti i Arteve
7. Nderim Zeqiri – Fakulteti i Shkencave të Zbatuara.

(2) Anëtarët nga paragrafi (1) i këtij neni zgjidhen publikisht me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Senatit të Universitetit të Tetovës.

(3) Të drejtat dhe detyrimet e Komisionit Universitar të Zgjedhjeve përcaktohen me Ligjin për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/18 dhe 178/21) dhe me Statutin e Universitetit të Tetovës, dhe zbatohen këto përgjegjësi:

- Sjell udhëzime me të cilat përcaktohet: puna e tij dhe puna e komisioneve zgjedhore të njësisive, mënyra e votimit dhe numërimi i votave, rezultati i votimit, mënyra, afati dhe të ngjashme për komunikim dhe dorëzimin e dokumenteve, akte, njoftime, procesverbale etj, ruajtja dhe qasja në dokumentacionin zgjedhor, dhe për çështje të tjera lidhur me procedurën për zbatimin e votimit dhe konfirmimin e rezultateve nga votimi;

- nga radhët e anëtarëve zgjedh kryetar dhe nënkryetar. Kryetari zgjidhet në seancën konstituive. Deri në zgjedhjen e kryetarit, seanca drejtohet nga anëtari më i vjetër;
- Përcakton afate në të cilët duhet të formohen komisionet zgjedhore të njësisive;
- Emëron anëtarë të komisioneve zgjedhore nëse njësia nuk formon komision zgjedhor në afatin e paraparë;
- Jep instruksione të domosdoshme për komisionet votuese, me kërkesë të tyre dhe sipas vlerësimit të vet;
- Përcakton kornizë kohore për zbatimin e aktiviteteve të nevojshme për zgjedhjen e rektorit;
- E përcakton ditën e votimit;
- I përcakton formularët e fletëvotimeve dhe procesverbalit për rezultatet e votimit për zgjedhjen e rektorit, për njësitë e Universitetit;
- Vendos për ankesa në pajtim me Statutin e Universitetit;
- Në bazë të rezultateve të votimit, e shpall kandidatin e zgjedhur për rektor;
- I sumon rezultatet e votimit për zgjedhje të rektorit dhe e shpall publikisht vendimin për kandidatin e zgjedhur;
- të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara me Ligjin për arsimin e lartë, Statutin e Universitetit dhe udhëzimet e komisionit.

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.



Kryetari i Senatit,
Prof. Dr. Vullnet Ameti